



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Udhëzim i Njesisë së Paraburgimit

Kushtet e sigurisë për hyrje në objektin e paraburgimit

Miratuar nga:	Administratorja, Dhomat e Specializuara të Kosovës
Data e miratimit:	23 shtator 2020
Nxjerrë nga:	Shefi i Paraburgimit
Data e nxjerrjes:	23 shtator 2020
Data e hyrjes në fuqi:	23 shtator 2020
Zëvendëson:	Nuk ka
Numri:	KSC-BD-32

Dhomat e Specializuara të Kosovës

Udhëzim i Njesisë së Paraburgimit mbi Kushtet e Sigurisë për Hyrje në Objektivin e Paraburgimit

KSC-BD-32

Përmbajtja

KREU I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
PJESA 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI	2
PJESA 2	KUSHTET E PËRGJITHSHME	3
KREU II	MASAT E SIGURISË	3
PJESA 3	DETEKTORËT E METALEVE	3
PJESA 4	KONTROLLI I PERSONIT	4
PJESA 5	GJËSENDET PERSONALE	4
KREU III	FOSH NJAT DHE FËMIJËT	5
PJESA 6	FOSH NJAT	5
PJESA 7	FËMIJËT	5
KREU IV	MBULIMI I FYTYRËS	6
PJESA 8	MASAT E SIGURISË.....	6
KREU V	KONTROLLE TË TJERA	6
PJESA 9	GJATË VIZITAVE.....	6
PJESA 10	SENDE TË RREZIKSHME TË NDALUARA	7
PJESA 11	MASAT PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT PUBLIK	7

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Pjesa 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Shefi i Paraburgimit i Njesisë së Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Njësia e Paraburgimit') nxjerr këtë Udhëzim në përputhje me rregullën 4.6 të Rregullores së Paraburgimit, me miratimin e Administratores. Ky Udhëzim përcakton kushtet e sigurisë që duhet të përmbushin personat për të hyrë në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ('objekti i paraburgimit') që gjendet në burgun holandez në Hagë ('burgu'). Duke qenë se gjendet brenda burgut, për të hyrë në objektin e paraburgimit personat duhet të përmbushin kushtet e sigurisë së vetë burgut.
2. Qëllimi i kushteve të sigurisë të përcaktuara në këtë Udhëzim është garantimi i sigurisë dhe rregullit në objektin e paraburgimit dhe mbrojtja e shëndetit të të paraburgosurve dhe të tjerëve. Në veçanti, nëpërmjet kushteve të sigurisë synohet parandalimi i futjes së sendeve të ndaluara prej rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit, të shtjelluara më tej në Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit për Sendet dhe Substancat e Ndaluar në Objektivin e Paraburgimit ('sendet e ndaluara').
3. Ky Udhëzim rregullon procedurat e sigurisë dhe të kontrolleve të:
 - a. mbrojtësve dhe vizitorëve të tjerë, si dhe gjëseneve të tyre personale, në përputhje me nenin 10.3 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve dhe nenin 13.2 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet, miratuar në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit; dhe

Dhoma e Specializuarë të Kosovës
Udhëzim i Njësisë së Paraburgimit mbi Kushtet e Sigurisë për Hyrje në Objektivin e Paraburgimit

KSC-BD-32

- b. personave të tjerë që mund të jenë të autorizuar të hyjnë në objektin e paraburgimit, si për shembull mjekët e jashtëm, si dhe gjësendeve të tyre personale, në përputhje me rregullën 34.4 të Rregullores së Paraburgimit.
4. Ky Udhëzim interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit, duke përfshirë Udhëzuesin e Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve dhe Udhëzuesin e Punës për Vizitat dhe Komunikimet.

Pjesa 2 Kushtet e përgjithshme

1. Për hyrjen në objektin e paraburgimit, vizitori, ose një person tjetër përcaktuar në pjesën 1.3, duhet:
- a. të paraqesë dokument të vlefshëm identiteti me fotografi të pranueshme nga Njësia e Paraburgimit dhe burgu, përkatësisht pasaportë ose letërnjoftim të shtetit përkatës;
 - b. të japë pëlqimin për t'u kontrolluar; dhe
 - c. të përmbushë kushtet e përcaktuara në këtë Udhëzim dhe kushtet e sigurisë të burgut. Një person mund ta tërheqë pëlqimin e vet në çfarëdo kohe.
2. Personit që refuzon t'u përmbahet masave në fuqi në lidhje me sigurinë apo e tërheq pëlqimin e vet për kontrollin, nuk i lejohet hyrja në burg dhe në objektin e paraburgimit.
3. Kur ky Udhëzim i referohet pëlqimit ose lejes së një personi për personat nën moshën 18 vjeç, kjo nënkupton pëlqimin ose lejen përkatësisht të prindit ose kujdestarit, sipas rastit.
4. Procedurat e sigurisë dhe kontrollet kryhen gjithmonë në mënyrë që respekton:
- a. dinjitetin dhe privatësinë e personit dhe të gjësendeve personale të tij;
 - b. shëndetin, gjendjen fizike, aftësi të kufizuara të mundshme të personit dhe masat e shëndetit publik;
 - c. materialet e përfshira në konfidencialitetin e komunikimit mbrojtës-klient, në përputhje me nenin 10.3 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve; dhe
 - d. letërkëmbimet e të paraburgosurve me KNKK-në, Avokatin e Popullit, Administratorin ose anëtarë të personelit që veprojnë në emër të tyre, një gjykatës apo panel të Dhomave të Specializuara ose anëtarë të personelit që veprojnë në emër të tyre, apo çfarëdo autoriteti gjyqësor të njohur nga Administratori, të cilat, në përputhje me nenet 21 deri 23 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet, nuk mund të hapen ose lexohen nëse janë shënuar qartë.

KREU II MASAT E SIGURISË**Pjesa 3 Detektorët e metaleve**

1. Para se të hyjnë në objektin e paraburgimit, të gjithë vizitorët dhe personat e tjerë përcaktuar në pjesën 1.3, kalojnë nëpër pikën e kontrollit të sigurisë. Në pikën e kontrollit të sigurisë, personat:
- a. heqin teshat e jashtme, duke përfshirë pallton, xhaketën, dorëzat, kapelën dhe shallin;
 - b. vendosin sendet e lartpërmendura dhe sende të tjera që kanë me vete në tabakanë që u jepet për këtë qëllim; dhe
 - c. kalojnë përmes një detektori të metaleve.
2. Nëse aktivizon alarmin e detektorit të metaleve, personit i kërkohet:
- a. t'i heqë sendet të cilat aktivizojnë alarmin; dhe

- b. të kalojë përmes detektorit të metaleve edhe një herë.
3. Oficerët e paraburgimit mund ta kontrollojnë një person me detektor dore të metaleve, në rast se alarmi aktivizohet përsëri gjatë kalimit të personit përmes detektorit të metaleve, ose kur, për arsye të tjera, oficerët e paraburgimit e gjykojnë të nevojshme për të kontrolluar nëse personi ka sende të ndaluara.

Pjesa 4 Kontrolli i personit

1. Pas masave të sigurisë të përcaktuara në pjesën 3, oficerët e paraburgimit mund të vendosin ta kontrollojnë një person me anë të kontrollit trupor sipër teshave në qoftë se detektori i dorës i metaleve tregon praninë e sendeve metalike, ose kur për arsye të tjera dyshohet se ka ndonjë send të ndaluar në teshat e personit, apo në ose rreth trupit të tij.
2. Pasi personi të ketë dhënë pëlqim për kontroll trupor sipër teshave, kontrollin e kryen një oficer i paraburgimit i së njëjtës gjini me personin që kontrollohet, në praninë e një oficeri tjetër të paraburgimit. Për të kontrolluar nëse personi ka sende të ndaluara, oficeri i paraburgimit e përshkon gjithë trupin e veshur të personit me pëllëmbë të hapura të duarve. Oficeri i paraburgimit gjithashtu i përshkon me gishta flokët e personit. Nuk bëhet kontroll i veshëve, hundës ose gojës.
3. Si pjesë e kontrollit trupor sipër teshave, në qoftë se konsiderohet e nevojshme për qëllimet e specifikuar në pjesën 1.2, personit mund t'i kërkohet:
 - a. t'i heqë këpucët; në një rast të tillë, oficeri i paraburgimit i kontrollon me dorë shputat e këmbëve të personit;
 - b. t'i zgjidhë dhe t'i shkundë flokët, veçanërisht nëse flokët janë të gjatë; në një rast të tillë, kontrolli trupor sipër teshave të personit kryhet jashtë rrezes së shikimit të personave të tjerë.
4. Për mbrojtjen e shëndetit të të paraburgosurve dhe të tjerëve në objektin e paraburgimit dhe me këshillën e mjekut të Njesisë së Paraburgimit, shefi i paraburgimit mund t'u kërkojë oficerëve të paraburgimit të mbajnë veshur pajisje mbrojtëse personale kur kryejnë kontrollimin e personave.

Pjesa 5 Gjësendet personale

1. Për të parandaluar sjelljen e sendeve të ndaluara, të gjitha sendet që personi ka me vete, si edhe teshat e jashtme:
 - a. kalojnë në aparatit me rreze Röntgen; dhe
 - b. inspektohen me sy, pa u hapur.
2. Në rast se dyshohet që ka një send të ndaluar, personit mund t'i kërkohet:
 - a. ta hapë vetë ndonjërin nga gjësendet; dhe/ose
 - b. t'u japë leje punonjësve të Njesisë së Paraburgimit ose të burgut që t'i hapin gjësendet përkatëse;
të lejojë inspektimin vizual të përmbajtjes së tyre për të eliminuar dyshimin.
3. Njësia e Paraburgimit dhe vetë personeli i burgut, sipas nevojës mund të përdorin metoda të tjera për të kontrolluar, për shembull, praninë e substancave të ndaluara të cilat mund të mos diktohen përmes aparatit me rreze Röntgen ose inspektimit vizual.
4. Inspektimi vizual i gjësendeve personale kryhet duke respektuar pjesën 2.4.c dhe 2.4.d, sipas rastit.
5. Me zbatimin e të gjitha masave në fuqi të sigurisë dhe para se të hyjë në mjediset e objektit të paraburgimit, si për shembull në mjediset për vizita kur është vizitor, personi vendos teshat e veta

të jashtme, si dhe gjësende të tjera që mund t'i kërkohen nga oficeri i paraburgimit, në dollapët për ruajtjen e gjësendeve në objektin e paraburgimit.

KREU III FOSHNJAT DHE FËMIJËT

Pjesa 6 Foshnjat

1. Kur kalojnë përmes detektorit të metaleve përmendur në pjesën 3.1, fëmijët e moshës nën 12 muaj ('foshnjat') mbahen në krah nga prindi ose kujdestari, sipas rastit, pasi ky i fundit t'i ketë përmbushur masat përkatëse të sigurisë. Foshnjat mund të kontrollohen me detektor dore të metaleve në përputhje me pjesën 3.3.
2. Shefi i paraburgimit mund të vendosë që një foshnjeje t'i bëhet kontroll i plotë ose i pjesshëm trupor sipër teshave, në qoftë se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:
 - a. ekziston dyshimi për praninë e një sendi të ndaluar në teshat e foshnjës, ose në apo rreth trupit të foshnjës;
 - b. kontrolli trupor sipër teshave është i domosdoshëm për të verifikuar praninë e mundshme të një sendi të ndaluar; dhe
 - c. nuk ka asnjë masë tjetër sigurie më pak ndërhyrëse për verifikimin e pranisë së mundshme të një sendi të ndaluar.
3. Në rast se prindi, ose, kujdestari i foshnjës, sipas rastit, jep pëlqimin për kontroll trupor sipër teshave të foshnjës, kontrolli kryhet:
 - a. nga një oficer paraburgimi, në praninë e një oficeri tjetër të paraburgimit;
 - b. në praninë e prindit, ose kujdestarit të foshnjës, sipas rastit; dhe
 - c. duke u kushtuar vëmendje dhe kujdes të posaçëm rehatisë dhe mirëqenies së foshnjës.
4. Para dhe gjatë zbatimit të masave të sigurisë në bazë të kësaj pjese, oficerët e paraburgimit sigurojnë që foshnja të ndjehet mirë.
5. Shefi i Njësisë së Paraburgimit evidenton me shkrim arsyet e kontrollit trupor sipër teshave të foshnjës, si edhe pëlqimin ose refuzimin e prindit, ose kujdestarit të foshnjës, sipas rastit, për kryerjen e këtij kontrolli.

Pjesa 7 Fëmijët

1. Masat e sigurisë përcaktuar në këtë Udhëzim fëmijët e moshës prej 12 muaj deri në 18 vjeç ('fëmijët') i përmbushin me ndihmën e prindit, ose kujdestarit, sipas rastit. Kur një fëmijë i vogël duhet të mbartet në krah për të kaluar përmes detektorit të metaleve, zbatohet pjesa 6.1. Fëmijët mund të kontrollohen me detektor dore të metaleve në përputhje me pjesën 3.3.
2. Oficerët e paraburgimit mund të vendosin që një fëmijë t'i bëhet kontroll i plotë ose i pjesshëm trupor sipër teshave në rrethanat e përcaktuara në pjesën 4.1.
3. Në rast se prindi, ose kujdestari i fëmijës, sipas rastit, jep pëlqimin për kontroll trupor sipër teshave të fëmijës, kontrolli kryhet:
 - a. nga një oficer paraburgimi i së njëjtës gjini si fëmija dhe në praninë e një oficeri tjetër të paraburgimit;
 - b. në praninë e prindit, ose kujdestarit të fëmijës, sipas rastit; dhe
 - c. duke u kushtuar vëmendje dhe kujdes të posaçëm rehatisë dhe mirëqenies së fëmijës.

4. Oficerët e paraburgimit u shpjegojnë fëmijëve procesin e zbatimit të masave të sigurisë për aq sa është e realizueshme dhe në një mënyrë që i përshtatet moshës së fëmijës, dhe në qoftë se konsiderohet e nevojshme, i kërkojnë prindit, ose kujdestarit të fëmijës, sipas rastit, që të ndihmojë me shpjegimet.
5. Para dhe gjatë zbatimit të masave të sigurisë, oficerët e paraburgimit sigurojnë që fëmijët të ndjehen mirë.

KREU IV Mbulimi i fytyrës

Pjesa 8 Masat e sigurisë

1. Vizitoreve që mbajnë vel ose mbulesë tjetër të fytyrës për arsye fetare, nuk u kërkohet që ta zbulojnë fytyrën ose flokët në vend publik ose para personave të gjinisë tjetër.
2. Oficerët e paraburgimit mund të vendosin që vizitoreve të tilla t'u kërkojnë ta heqin velin ose mbulesën e fytyrës kur kjo është e nevojshme për identifikimin e tyre apo për të kontrolluar nëse kanë sende të ndaluara. Në qoftë se një vizitor jep pëlqimin për heqjen e velit apo mbulesës së fytyrës, sipas rastit, kjo bëhet:
 - a. për aq sa është e nevojshme për qëllimin e lartpërmendur;
 - b. në ambient privat dhe në prani të një punonjëseje; dhe
 - c. nga vetë vizitorja.
3. Kur vizitorët mbajnë mbulesë fytyre si p.sh, maskë për arsye të tjera të tilla si masat për mbrojtjen e shëndetit publik, paragrafi 2 zbatohet *mutatis mutandis*.

KREU V Kontrolle të tjera

Pjesa 9 Gjatë vizitave

1. Pas hyrjes në objektin e paraburgimit dhe gjatë kohës së qëndrimit të tyre aty, vizitorëve ose personave të tjerë përmendur në pjesën 1.3 mund t'u kërkohet që t'u përmbahen masave të sigurisë sikurse përcaktohen në këtë Udhëzim, në qoftë se ekzistojnë arsye për të dyshuar se kanë ndonjë send të ndaluar në teshat e tyre, apo në ose rreth trupit të tyre. Në një rast të tillë, oficerët e paraburgimit vendosin se cila masë e sigurisë duhet të ndërmerret dhe në çfarë mase, për të eliminuar dyshimin. Për kontroll trupor sipër teshave të një foshnjeje vendos shefi i paraburgimit, sikurse kërkohet në pjesën 6.2.
2. Kur kanë arsye për të dyshuar se ka një send të ndaluar në teshat e jashtme ose ndër sendet e tjera që personi i ka lënë në dollap në objektin e paraburgimit sipas pjesës 5.5, oficerët e paraburgimit inspektojnë sendet në dollap në praninë e personit, për të eliminuar dyshimin.
3. Për kryerjen e kontroleve të sigurisë sipas kësaj pjese, shefi i paraburgimit, ose oficerët e paraburgimit, sipas rastit, mund ta ndërpresin ose përfundojnë një vizitë në bazë të nenit 8 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet.

Pjesa 10 Sende të rrezikshme të ndaluara

Në rast të dyshimit për sende të rrezikshme të ndaluara, si armë, municion, mjete shpërthyes, drogë apo substanca psikotropike, shefi i paraburgimit, ose oficerët e paraburgimit, sipas rastit, mund të ndërmarrin masa sigurie që i gjykojnë të nevojshme për garantimin e sigurisë dhe rregullit në objektin e paraburgimit, pa lejen ose praninë e personit, duke përfshirë kur sendi është vendosur në dollap.

Pjesa 11 Masat për mbrojtjen e shëndetit publik

1. Për mbrojtjen e shëndetit të të paraburgosurve dhe të tjerëve me këshillën e mjekut të Njesisë së Paraburgimit, Administratori ose shefi i paraburgimit mund ta gjykojnë të domosdoshme që vizitorët t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me shëndetin publik dhe të matin temperaturën ose t'u nënshtrohen kontrolleve të tjera shëndetësore para se të lejohen të hyjnë në objektin e paraburgimit. Vizitorëve mund t'u refuzohet hyrja për arsyet e lartpërmendura.
2. Për të njëjtën arsye me këshillë të mjekut të Njesisë së Paraburgimit Administratori ose shefi i paraburgimit mund ta gjykojnë të domosdoshme që vizitorët të mbajnë veshur pajisje mbrojtëse personale gjatë kohës që janë në objektin e paraburgimit, duke përfshirë edhe gjatë vizitave të tyre, të dezinfektojnë duart kur hyjnë dhe të zbatojnë masa të tjera higjienike si edhe të mbajnë njëfarë distance fizike nga të paraburgosurit dhe të tjerët gjatë kohës që janë në objektin e paraburgimit. Vizitorëve mund t'u refuzohet hyrja ose t'i jepet fund vizitës së tyre për mosrespektim të masave të lartpërmendura